



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr06-39306 /2020

Klinë, 30. 10. 2020

#### EKSTRAT-PROCESVERBAL

I Seancës së rregullt, të punës së Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur më 30. 10. 2020, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, hapi seancën e rregullt të punës duke përshëndetë kryetarin e Komunës, z. Zenun Elezaj, Drejtorët e Drejtorive, si dhe në veçanti z. Shemsedin Berisha i cili është emëruar drejtor i Shëndetësisë së fundmi dhe është për herë të parë në këtë seancë në detyrë të drejtorit, anëtarët e Kuvendit dhe gjithë të pranishmit në sallë. Para se të prezantoi Rendin e Ditës, kryesuesi theksoi se në sallë janë prezent 25 anëtarë të Kuvendit dhe se për anëtarin Baki Gashi ka arsyetim mungese. Kryesuesi theksoi se për mungesën e anëtarëve të tjerë nuk ka njoftim me shkrim prandaj nuk ka arsyetim. Ai tha se nuk ka të drejt që të tjetërsoj asnjë arsyetim që bëjnë anëtarët e kuvendit për mungesën e tyre të mundshme. Secili konfirmim që na ven nga cilido anëtar i Kuvendit për mungesën e tij, ajo është mungesë me arsyen.

Pjesën tjetër e ka rregulluar ligji përmes të cilit KQZ ia merr anëtarit të kuvendit mandatin pas tre mungesave të pa arsyeshme, e jo ne. Pas kësaj që tha kryesuesi, ai kaloj në pikën e dytë të rendit të ditës, e cila është shqyrtimi dhe miratimi i proces verbalit të mbledhjes së kaluar.

Për këtë pikë të rendit të ditës ishin dy kërkesa për plotësim pasi që anëtarë i kuvendit, z. Arben Limanaj kishte konstatuar se fjala e tij në lidhje me buxhetin dhe tri rrugët e propozuara nga ai për asfaltim në fshatin Caravik nuk ishin specifikuar me emër të lagjeve në proces verbal. Z. Limanaj kërkoj që të plotësohet saktësisht sipas audioincizimit. Si dhe anëtarja e kuvendit, znj. Violeta Zefi e cila kërkoj që fjala e sajë e parë në Kuvend në seancën e kaluar të hiqet kështu siç është e shkruar në procesverbal dhe të shkruhet rishtas ashtu siç është në audio incizim. Prosesverbalit pa vërejtje të tjera u MIRATUA me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe Miratimi i rekomandimeve të KPF-së

Kryesuesi kërkoj nga anëtarët e kuvendit që këto rekomandime të votohen për ose kundër në pako pasi që në vazhdim do të shkoqiten një nga një të gjitha.

Rekomandimet e KPF-së u MIRATUAN me 25 vota për, asnë kundër dhe asnë abstenim.

#### Pika 4 e Redit të Ditës: Shqyrtimi i Raportit Financiar për 9-të mujorin e vitit 2020

Kryesuesi fillimisht njoftoj të pranishmit se tanë më ky raport është printuar në format të madh dhe se aty është një gabim teknik. Në vend të "Janar-Shtator 2019" duhet të jetë "Janar-Shtator 2020". Kryesuesi sqaroj se këtë raport e kemi shqyrtuar edhe në KPF dhe se ky raport edhe në kuvend është vetëm shqyrtim dhe jo aprovim. Fjalën a dha zv. drejtorit të drejtorisë së FEZH, z. Ajet Sejdiu.

z. Ajet Sejdiu, zv. drejtor i FEZH: Përrshëndetje kryetar, kryetar i kuvendit, drejtorë të drejtorive, këshilltarë të nderuar, të gjithë të pranishmit. Drejtoria e FEZH sipas kompetencave të veta duke u bazuar në ligjet adekuate ka hartuar raportet obligative që në këtë rast është edhe ky raport financiar nëntë mujor. Ky raport paraqet gjendjen e buxhetit, shpenzimet dhe të hyrat për këtë periudhë raportuese. Pra, siç e shihni buxheti i planifikuar dhe i aprovuar në këtë asamble, për vitin 2020 është 11 milion e 768 mijë e 377,22 euro. Krahasuar me vitin e kaluar është për 12.8 % më i lartë. Granti Qeveritar është burimi kryesorë i financimit të buxhetit komunal që shihet edhe në tabelë, ku pjesëmarrja është 89.06% në vitin 2020 ( vlera 10,480,756.80 ). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 14.04 % më i lartë. Nga kjo nënkuptoitet se jemi të varur nga ky burim i financimit .

Të hyrat vetanake- Siç shihet edhe në tabelë buxheti nga THV është 915,074.00 € ( 7.78 % e buxhetit total në këtë periudhë ) . Ndërsa në raport me vitin paraprak buxheti nga THV është më i ultë për 0.66 % Të hyrat vetanake të bartura- Buxheti nga THV të bartura është 361,621.56 ( 3.07% e buxhetit total në këtë periudhë ) . Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit ,si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe Donacionet e bartura siç janë : - Participimi i qytetarëve në vlerë 10,924.86 € , në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetar është 46.37 % më i lartë se në vitin paraprak. Buxheti i shpenzuar në periudhën janar – shtator 2020 në vlerë 6,353,570.16 € është 53.99 % e buxhetit në SIMFK për nëntëmujorin e 2020.Nga Granti qeveritar 5,878,085.98 € ( 56.08 % në raport me buxhetin nga Granti ), nga të hyrat vetanake 244,514.04 € ( 26.72 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2020 ) , nga të hyrat e bartura 225,122.40 € ( 62.25% në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura ) dhe nga participimi i qytetarëve 5,847.74 € ( 53.53 % në raport me buxhetin nga participimet . Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 6,353,570.16 € nga granti qeveritar janë 92.52% , nga të hyrat vetanake 3.85 % , nga të hyrat e bartura 3.54 %, dhe nga participimet 0.06 % .Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të ultë për rrëth 7.35 % krahasuar me periudhën e njëjtë të viti paraprak . Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – shtator 2020 në vlerë 6,353,570.16 € për paga dhe ,mëditje janë

shpenzuar 4,579,029.72 € (72.07% e shpenzimeve ), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 732,082.47 € ( 11.52% e shpenzimeve ), për shërbime komunale 87,087.37 € ( 1.37 % e shpenzimeve ), për subvencione 117,159.74 € (1.84 % e shpenzimeve ) dhe për kapitale 838,210.86 € (13.19 % e shpenzimeve ). Shpenzimet në periudhën janar-shtator 2020 në vlerë 6,353,570.16 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2019 në vlerë 6,857,538.04 € janë zvogëluar për rreth 7.35 % . Shpenzimet për paga dhe meditje krahasuar me vitin paraprak janë rritë rreth 3.09 % , shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritë rreth 10.38 %, shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për rreth 14.70% , shpenzimet për subvencione janë rritë për 96.00 % dhe shpenzimet për kapitale janë zvogëluar për rreth 47.31 %.

Z. Sejdiu e përfundoi raportimin duke thënë se për çdo detaj që ju intereson anëtarëve të Kuvendit, ai është në dispozicion dhe jo vetëm ai por gjithë ekzekutivi. Ndërkaq kryesuesi I Kuvendit z. Fadil Gashi, hapi debat për këtë raport.

Pika e 5 e Rendit të Ditës: Propozim – Vendim për transferim të mjeteve nga drejtoria e FEZH.

Kryesuesi theksoi se në KPF është shqyrtuar ky propozim – vendim, jemi dakorduar që deri në këtë seancë drejtoria në fjalë me I saktësuar dhe ju sot e keni përpara një draft të ri.

Edhe për këtë pikë të rendit të ditës kryesuesi I Kuvendit hapi debat por pasi që nuk kishe asnjë të interesuar për debat, ky propozim-vendim u nxor në votim dhe me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA.

Pika e 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I kërkesës së sindikatës së pavarur të punëtorëve të administratës së komunës në Klinë.

Kryesuesi theksoi se është pranuar një kërkesë nga sindikata që kërkon ndihmën në pagesën e shujtave për punëtorët e administratës. Ai shtoj duke thënë se vendimin për këtë kërkesë ka ardhë në kuvend I cili në fund do ë votoj. Paraprakisht hap debat për temën.

Z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për të gjithë. Në emër të grupit të AAK-së e përkrahi kërkesën e punëtorëve të administratës dhe e konsideroj që është kërkesë shumë e drejt pasi që sa I përket të ardhurave punëtorët e administratës janë më së keqi.

Znj. Violeta Zefi: Edhe në KPF kur e kemi shqyrtuar, unë e kam shprehur qëndrimin tim pro kësaj kërkesë të shoqatës së sindikatës së pavarur të administratës në Komunën tonë. Në të njëjtën kohë edhe në emër të grupit kuvendar të LDK-së e mbështesim kërkesën në fjalë.

z. Esat Raci: Përshëndetje të gjithëve. Pasi që shefi I grupit nuk është këtu, në emër të grupit e mbështesim kërkesën e sindikatës së pavarur të punëtoreve të administratës.

z. Xhevxhet Berisha: Përshëndetje të gjithëve. Edhe ne si grup kuvendar e mbështesim këtë kërkesë.

Kryesuesi në fund e nxori në votim dhe me 22 vota pér, asnë kundër dhe asnë abstenim u MIRATUA .

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I draft kodit të etikës pér zyrtarët e Komunës së Klinës.

Kryesuesi theksoi se edhe këtë draft e kemi shqyrtuar dhe debatuar e më pastaj është térhequr , por që tash ka ardhur drafti unik nga ministria e pushtetit lokal, I njëjti draft ju ka dërguar të gjitha Komunave dhe është kërkuar që të votohet në kuvendin Komunal.

Hapet debat rreth kësaj pike por pasi që asnë nga anëtarët e kuvendit nuk e morri fjalën, kryesuesi e nxori në votim dhe me 22 vota pér,asnë kundër dheasnë abstenim U MIRATUA.

Pika 8 e Rendit të Ditës: Propozim- vendim pér vënien në diskutim publik të draft-rregullores pér fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Klinës.

Kryesuesi theksoi se në seancën e kaluar, kuvend ka marr një vendim pér shfuqizimin e vendimit që përcaktonte ditën e diele si ditë pushimi. Sot e kemi para një draft rregullore që është dashur të ndryshohet. Kjo rregullore ka me ardhë prap në kuvend pér shqyrtimin ndërkaq sot kërkohet vendimi I ynë që ky draft të qit në diskutim publik pér të marr vërejtje e opinione nga të gjitha kategoritë që I prek kjo rregullore. Pasi që u nxor në votim, me 23 vota pér asnë kundër dheasnë abstenim U MIRATUA.

Pika 9 e Rendit të ditës: Propozim-vendim pér caktimin e lokacionit pér tregun e gjelbër.

Kryesuesi e theksoi se materialin e keni dhe se e keni idenë se pér ku bëhet fjalë. Gjithashtu ai theksoi se me hartat zonale ku kuvend ka miratuar lokacionin e autobusëve se ku është tregu I gjelbër tanë dhe se tregu duhet të kaloj sipas propozimit aty te hapësirat e shkollës së mesme.

z. Isa Ibishi: Përshëndetje pér të gjithë. Dua që të nisem nga pika praparake- propozim – vendim pér vënien në diskutim publik të draft-rregullores. Ai vendim është rishqyrtuar dhe Brenda një muaji a dy ëshë térhequr. Pra më erdhi mirë rruga se si ëshë térhequr ai vendim pasi që nuk ka pasur mundësi të implementohet nga bizneset. Pra aty ku mendojmë që nuk është mirë, të analizojmë dhe të sjellim një vendim në të mirë të qytetarëve. E them këtë edhe në kontekstin edhe të kësaj pike pér zhvendosjen e tregut të gjelbër nga ku është. Mendoj që duhet ta mendojmë mirë dhe të gjejmë zgjidhje tjetër sepse mendoj që asnjeri nga ne nuk mendoj që është zgjidhje e duhur kjo që po propozohet. Të gjithë asamblistët që jetojnë në Klinë- qendër nuk besoj që pajtohen që tregun e gjelbër ta dërgojmë te nxënësit e shkollës fillore e të mesme dhe këtu në qendër ta ngarkojmë komunikacionin me autobusë.

- z. Tunë Dedaj: Flas në emrin tim personal. Diçka më të mirë se sa të sjellët stacioni I autobusëve aty ku është parapa nuk ka sepse në qendër zgresin nxënësit dhe I kanë afër shkollat. Sa I përket tregut të gjelbër, nuk është se jam shumë dakord. Ndoshta është mirë të gjendet një vend tjetër ku nuk do të I pengonte nxënësit.
- z. Fadil Gashi, kryesues: Stacioni I autobusëve është kërkesë urgjente duke pas parasysh të gjitha vështirësitë që po krijohen me mungesën e tij. E keni pa se kur të vijnë autobusët radhë sa e ka të vështirë të futet në qytet një makinë tjetër. Prandaj është shumë me rëndësi që të ketë një lokacion ku ndalojnë, parkohen e nisen autobusët dhe nuk I pengojnë makinat e tjera. Caktimi I lokacionit për tregun e gjelbër është I përkohshëm. Në momentin që e gjejmë një lokacion tjetër më të përshtatshëm prap e sjellim në kuvend dhe marrim vendim. Por derisa ta gjejmë një lokacion tjetër është menduar se vendi më I përshtatshëm është atje ku u tha dhe po propozohet. Ndërkaq për lokacionin e autobusëve ne e kemi marr vendimin më parë me hartat zonale.
- z. Valmir Bacaj: Përvendetje për të gjithë. Të gjithë e dimë që është kërkesë imediate e qytetarëve caktimi I lokacionit për stacionin e autobusëve dhe ne si kuvend me votimin e hartave zonale e kemi caktuar lokacionin. Hartat zonale siç e dimë nuk mund të ndryshohen brenda 5 viteve. Si grup Kuvendar e konsiderojmë si nevojë imediate investimi në hapësirën e lokacionit të autobusëve prandaj jemi dakord që tregu I gjelbër të vendoset atje ku është paraparë sipas propozimit.
- z. Fadil Gashi, kryesues: Vetëm edhe një herë ta sqarojmë. Ne po flasim për një vendim që do ta marrim e që është dhe quhet Vendim I përkohshëm I lokacionit për tregun e gjelbër. Le ta quajmë kështu në mënyrë që në vazhdimësi të bëjmë përpjekje për të gjetur një lokacion tjetër më të përshtatshëm dhe më të pranueshëm.
- z. Sefa Morina: Përvendetje të gjithëve. Këtu po flitet për një lokacion të përkohshëm. A do të ketë investime dhe shpenzime në atë lokacion ë përkohshëm. Nesër mund të kalohet në një vend tjetër e ndërkohe ne po krijojmë shpenzime në këtë të përkohshmen. Gjithashtu dua të theksoi se pak nuk pajtohem me atë që deklaroj z. Ibishi, për arsy se në fjalën e tij tha se të gjithë asamblistët duan të bëjnë zgjidhje të mirë për qytetarët, e më pastaj tha gjithashtu se ndoshta se përveç asamblistëve që jetojnë në qendër të tjerët nuk kanë interes se ku caktohen lokacionet e autobusëve dhe tregut. Dua të I them se ne jemi përfaqësues të të gjithë qytetarëve. Shqetësimi im është se aty ku është vendosë stacioni I autobusëve është vend shumë I vogël dhe ditëve do të bëhet ngarkim edhe më I madh se që është e sidomos të martave kur është ditë tregu. Është rrugë transit ku qarkullojnë shumë kamionë etj. prandaj mendoj që do të bllokohemi, nuk është mirë të ngutemi me vendime. Edhe për tregun e gjelbër, mendoj që nuk është I përshtatshëm sepse qytetarëve ju bjer të furnizohem në treg krejt në një krahë tjetër dhe është goxha një rrugë e gjatë që ata duhet ta bëjnë.
- z. Fadil Gashi, kryesues: Edhe një herë po e përsëris. Le të jetë vendim I përkohshëm, mos të ndalet as ekzekutivi dhe as ne që të gjejmë lokacion më të përshtatshëm në të

ardhmen. Kлина до тë ndryshoj dhe pas 10 viteve nuk I dihet edhe sa tregje tjera të gjelbër do të jenë.

z. Tush Dedaj: Përshëndetje. Unë mendoj se duhet të shihet funksionalitetin e kësaj rokade. Me siguri nuk është funksionale nëse një zonjë e lenë fëmijën në shqip dhe shkon e bënë treg të Drini I Bardhë. Edhe për nxënësit nuk e shoh shumë funksionale. Unë jam pro asaj që njerëzit të mos kenë nevojë të bëjnë rrugë të gjatë për të shkuar në treg. Të rrijë këtu ku është e të mos bëhen shpenzime pa arsy. Të shihet funksionalja dhe racionalja.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ju lutem, nuk jemi duke diskutuar lokacionin e Autobusëve, ajo punë është kryer kur kemi votuar hartat zonale. Nëse I futemi kësaj duke llogaritur se për kë është funksionale e për kë jo, s'kemi me ba zgjidhjen e duhur.

z. Xhevxhet Berisha: Unë pajtohem me faktin që për stacionin e autobusëve është gjithë kanë votuar përvèç një anëtarë I cili ka abstenuar me arsyen se nuk I ka pa hartat zonale. Unë e përkrahu që stacioni I autobusëve të jetë sipas hartave zonale sepse nuk e shohë të sigurt stacionin e autobusëve afër shkollave. Ndërsa tregu i gjelbër edhe pse është një pengesë shumë e madhe, jam dakord që të jetë afër shkollës "Fehmi Agani" asi që tregu zhvillohet vetëm një ditë në javë dhe mendoj se do të përballohet. Pra jam dakord me propozimin siç na ka ardhur gjithmonë duke besuar për një zgjidhje më të favorshme në të ardhmen.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit. Dëshiroj që të ndërlidhem pak me fjalën e Sefa Morinës, në lidhje me shpenzimet e mundshme për përgatitjen e tregut. Po, mund të ketë shpenzime të vogla në vlerë prej 5-6000 euro për shtrimin me kuba por që kjo infrastrukturë do të shërbejë edhe në të ardhmen pavarësisht nëse do të lëviz tregu nga aty ose jo. Nuk do të ketë shpenzime të veçanta. Aty do të investohet minimalisht. Tualete dhe ujë këtë planifikojmë të ndërtojmë. Ne si ekzekutiv, nuk kemi pasur mundësi që të gjejmë një hapsirë më të mirë publike për momentin.

Pasi që nuk kishte të interesuar të tjerë për debat, kryesuesi e nxori në votim dhe me 17 vota për, 4 vota kundër dhe 1 abstenim, U MIRATUA vendimi për caktimin e përkohshëm të lokacionit të tregut është gjelbër.

Pika 10 e Rendit të Ditës: Vizita në Shqipëri për ndërë të festive të Nëntorit.

Kryesuesi theksoi se në lidhje me vizitën e mundshme në Shqipëri përfestat e nëntorit, ka pasur përpjekje edhe përpëra por që s'kemi pasur mundësi ta realizojmë. Tani mendoj që janë krijuar rrethanat dhe kushtet që mund ta realizojmë këtë vizitë por gjithmonë duke pasur kujdes situatën e pandemisë dhe duke e përcjellë zhvillimin e sajë. Sot na duhet një vendim formal I kuvendit në mënyrë që të fillohen procedurat e prokurimit. Kryesuesi foli për idenë në formë skenari. Seancën e nëntorit ta mbajmë më herët, me datë 25 ose 26, pastaj të udhëtojmë në Gjirokastër pasi që jemi të

binjakëzuar me Gjirokastër, të bëjmë vizita edhe zyrtare në Gjirokastër gjithsesi, pastaj në Sarandë t nesërmen dhe me datë 28 të jemi në Vlorë. Kthimi të bëhet me datë 29.

z. Enver Berisha: Përshëndetje të gjithëve. Realisht siç e shpjeguar edhe ju, kur ka dalë kjo kërkesë për herë të parë, unë dhe grapi ynë nuk jemi dakorduar në atë kohë për shkak të arsyeve tona dhe kohës. Në këtë rast mendoj që jemi të gjithë dakord që kjo të ndodhë dhe të realizohet kjo vizitë në bazë të këtij intenerari që e kemi biseduar bashkërisht. Mendoj që s'kemi çfarë ta debatojmë më shumë. Ne jemi për dhe mbështesim realizimin e kësaj vizite.

Kryesuesi e nxori në votim dhe unanimisht pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim U MIRATUA.

Pas miratimit, kryesuesi kërkoj që për shkak të procedurave dhe nevojës për specifikim të procedurave të prokurimit, konfirmimi I pjesëmarries së gjithsecilit anëtarë veç e veç të bëhet deri të hënën me datë 2 Nëntor.

Pika 11 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje.

z. Enver Berisha: Ne e patëm ngritë një lloj shqetësimi se në qendër të Klinës po krijohet një lloj ngarkese e cila po vazhdon edhe sot e kësaj dite. Jemi qytetarë që lëvizim dhe shohim situatën edhe në komunën e tjera. Realisht në Komunën tonë duket se shtrëngimi është më I madh se kudo tjetër në Kosovë. Dhe përvèç kësaj, po flitet për mundësinë e karantinimit të Komunave. Komuna e jonë është një nga komunat më me së paku raste dhe do të doja që kryetari të mos lejoj që Kлина të barazohet me komunat që kanë numër të madh të të infektuarve në baza ditore. Qëllimi im është që të bëjë thirrje që mos të I bllokojmë qytetarët tanë pa nevojë.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Enver, shqetësimin që e prezantuat këtu e kam edhe unë të njëtin dhe e kam biseduar edhe me komandantin e policisë. Besoj është minimizuar paksa prezenca e ndalimeve në rrugë dhe qëndrimit në rreth të patrullave policore edhe nga tri të tillë ndonjëherë. Sepse edhe unë e konsideroj të panevojshme edhe pse ata e dinë punën e vet dhe e kryejnë me përgjegjësi të madhe. Sa I përket karantinimit, unë kategorik kundër izolimit të qytetarëve e komunës. Tani më kemi krijuar një përvojë me virusin dhe më së miri e luftojmë duke qenë të kujdeshshëm. Pavarësisht rritjes së numrit të të infektuarve në Kosovë e gjithandej botës, deri në momentin e fundit nuk do të karantinohem. Besoj që edhe niveli qendror do të jetë dakord me këtë. Të shtojmë kujdesin dhe ta luftojmë covidin me sukses.

z. Isa Ibishi: Faleminderit kryesues. Nuk dëshiroj që të I reagoj kolegut Sefa Morina, por vetëm të sqaroj se nuk pata asnjë qëllim që të bëjë dallime në mes qytetit e fshatit. Qëllimin e kisha që të ilustroj vështirësitë nga ngufatja e komunikacionit e atyre që jetojnë në qendër dhe lehtësirat që të ofron bashkësia lokale, fshati etj. Kjo ishte sa për sqarim. Ndërsa tani kam dy pyetje. 1. Rruga mbi lagjen Dragaj, pra, rruga "Dy martirët" deri tek shtëpia e dëshmorit Bekim Toverlani, është rrugë e pa asfaltuar dhe e pa kalueshme. E kam vizituar këtë rrugë dhe banorët e lagjes më kanë thënë se ka qenë

primitim I juaji kryetar që kjo rrugë të asfaltohet. Dhe e dyta, e diji qe nuk është në kompetencat e Komunës por a mund të bëjmë një rreth rrotullues në Dollc derisa ë investohet në rrugën Prishtinë-Pejë. Të insistohet në nivelin qendror. Sikur të jetë thjesht një rreth rrotullim.

z. Zenun Elezaj, kryetar Komune: për rrugën në lagjen Dragaj ne në vitin 2018 e kemi shtruar pjesën ë të madhe të rrugës. E dij që kanë mbetur edhe pak metra pa shtruar. Këtë vit e kemi në kod por jemi përcaktuar që të kemi investime për ujë të pijshëm për lagjen Bojaja dhe atë pjesë. Të shohim se çka mund ë bëjmë për vitin e ardhshëm. Nuk kemi kod port ë provojmë më fondin e përfomancës. Për udhëkryqin te rruga për Gjakovë, kërkesën për rreth rrotullim aty dy herë e kam bërë në qeveri, në ministrinë e infrastrukturës. Kemi pasur premtimi që do të bëhet shumë shpejt me rastin e vizitës së ministrit në Klinë. Kompania e mirëmbajtjes së rrugëve, ajo nuk e ka asnjë pengesë që ta rregulloj, megjithëkëtë nuk kemi gjetur mirëkuptim. Kompanitë shpesh herë po kërkojnë të fitojnë shumë dhe po l shfrytëzojnë momentet. Pavarësisht pengesave, ne nuk do të ndalemi derisa ta realizojmë.

Znj. Saranda Elezi: Përshëndetje për të gjithë. Kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve publike, z. Ibër Elezaj. Kanalizimi në fshatin Sferkë ka shpërthyer që para një muaji. Po kundërmon një erë e tmerrshme që jua ka bërë të mundimshme jetën banorëve për rreth. Drejtor a jeni qenë në fshatin Sferkë, a e keni a këtë problem dhe kur mendohet se mund të rregullohet?

z. Ibër Elezi, drejtor I SHP: Përshëndetje Sarandë, përshëndetje për të gjithë. Disa herë kam qenë dhe e kam parë nga afër atë problem. Herën e fundit kam qenë me drejtorin e arsimit. E kemi pak problem sepse Ndërmarrja publike Ambienti akoma nuk e ka futë në sistem të pagesave atë pjesë. Sikur ë kishte në sistem atëherë edhe e ka për detyrë që ta mirëmbaj kanalizimin në atë pjesë. Pavarësisht nga kush ka për detyrë e kush jo, ne kemi ba hapjen e një tenderi të ri përfurnizim me gypa kanalizimi dhe kompania në fjalë ta bëjë shtrirjen dhe rregullimin. Është për kritikë kjo punë, jo përfajin tim dhe as mos angazhimin, besoj që brenda muajit të ardhshëm kjo punë do të kryhet.

z. Fadil Gashi, kryesues: Është mirë që në seancën e ardhshme të shohim vendimin e kuvendit tonë me të cilin vendim këto ndërmarrje janë regionalizu. Ndoshta ka ardhë koha që të shohim se a kemi ndonjë profit që rijmë në regjion. Qytetari adresë të vetme I ka zyrat e komunës dhe Komunën. Qytetari nuk I din investimet tona në këto ndërmarrje, ai don shërbimin e duhur e që ky shërbim po ju mungon. Në një të ardhme të I rishqyrtojmë ato vendime, bahskë me kryetarin e ekzekutivin, dhe të mendojmë se a ti kthejmë ato ndërmarrje ku e kanë vendin duke shpresuar më pastaj se mund të I organizojmë më mirë dhe të ju shërbejmë qytetarëve më mirë. Në fund të fundi, ta debatojmë në kuvend këtë punë dhe ta bëjmë një vlerësim. Sepse Komuna po investon miliona euro në kanalizime e ujësjellës etj. e më pastaj ata po udhëheqin duke mos investuar asgjë të tyren dhe duke lënë mangu shërbimet për qytetarët.

z. Tunë Dedaj: Faleminderit. Unë kam një kërkesë për drejtorin e SHP. Z. Ibër Elezi, për qentë endacak nëpër rrugë që po rrezikojnë fëmijë dhe të tjerë. Kërkoj që të angazhohet drejtori në këtë problematikë. Këta qenë endacak po krijojnë problem edhe në bujqësi.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Agjencinë I veterinës(AVUK) në vitin 2018 ka marrë përgjegjësi që në nivel të Kosovës ta trajtoj këtë problem. Po ashtu ju ka nda buxhet për këtë çështje. Ne e kemi diskutuar edhe në aprovim buxhetin që e kemi bërë për vitin e ardhshëm dhe kemi menduar që përmes mallrave dhe shërbimeve që ka drejtoria e FE Zh të mundohemi edhe ne sadopak që të minimizojmë këtë problematikë. Është çështje e vështirë që të merremi të vetëm ne si Komunë pa I harmonizuar veprimet edhe me Komunat për rreth nesh. Gjithsesi mendojmë që më buxhetin e viti të ardhshëm të bëjmë diçka në këtë drejtim.

Kryesuesi I Kuvendit, z. Fadil Gashi duke konstatuar se nuk ka të interesuar ë tjerë për këtë pikë të rendit të ditës, dhe p[asi që ishte pika e fundit , ai falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesues:

Fadil Gashi

